



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 51
Prishtinë, më 8 shtator 2010
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Suzana Novoberdaliu, Eqrem Kryeziu, Basri Musmurati, Zylfi Merxha, Lulzim Zeneli dhe Radmila Vujoviq - anëtarë të Komisionit.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Antigona Ibraj, Blerina Pula dhe Afrim Hoti.

Mbledhjen e kryesoi: Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më **21.07.2010**,
3. Shqyrtimi i planit të punës për sesionin vjeshtor 2010,
4. Miratimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Policor,
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 21.07. 2010

Procesverbali i 21. 07. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i planit të punës për sesionin vjeshtor 2010

Kryetari i Komisionit – Është hartuar një plan i punës së Komisionit për muajt në vazhdim, ku është e paraparë dinamika e punës së Komisionit. Janë disa ligje që duhen miratuar me një procedurë më të shpejtë. Pritet që do të ketë edhe më shumë ligje që do të përfshihen në punën e Komisionit. Nëse nuk ka dikush diçka konstatoj që tani e kemi planin e punës.

4. Miratimi i propozimamendamenteve për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-037 për dokumentet e udhëtimit

Kryetari i Komisionit – Në mbledhjen e fundit e kemi caktuar referues deputetin Basri Musmuratin për shqyrtimin e Projektligjit për plotësim ndryshimin e ligjit për dokumentet e udhëtimit, të cilit ia jap fjalën për ta paraqitur para Komisionit Raportin me propozimamendamente.

Basri Musmurati – Ne e kemi shqyrtuar Projektligjin edhe me përfaqësuesit e Qeverisë, dhe Raporti përmban shtatë amendamente.

Kryetari i Komisionit – Nëse nuk keni ndonjë vërejtje propozoj t'i miratojmë amendamentet për këtë projektligj.

Anëtarët e Komisionit miratuan propozimamendamentet e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për dokumentet e udhëtimit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Policor

Kryetari i Komisionit – Projektligji për Inspektoratin Policor është miratuar në lexim të parë në Kuvend. Komisioni për siguri, si Komision FunkSIONAL do ta shqyrtojë këtë projektligj. Kanë ardhur vërejtje edhe nga EULEX - i në lidhje me këtë projektligj.

Shkumbin Demaliaj – Unë mendoj se pakënaqësitë më të mëdha janë shfaqur nga grupi më i madh parlamentar në lidhje me këtë projektligj. Vërejtjet më të mëdha janë dhënë për shkak të hapësirës së madhe që i është dhënë Inspektoratit Policor për hetim të brendshëm.

Kryetari i Komisionit – Në lidhje me këtë projektligj, si referues caktohet deputeti Shkumbin Demaliaj.

6. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit – Kemi marrë një ftesë për një vizitë zyrtare në Hungari. Në këtë vizitë Komisioni do ta vizitojë Parlamentin Hungarez, Komisionin për Mbrojtje, Akademinë Policore dhe institucionet e tjera, ku shpresojmë që do të vendosim bashkëpunim në të ardhmen në të gjitha fushat. Ne do të shprehim interesim për bashkëpunim, sidomos për çështjet që ndërlidhen me edukim dhe zhvillim.

Pasi nuk kishte pika të tjera për diskutim, kryetari i Komisionit e mbylli takimin.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Rrustem Mustafa